



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-040
Prishtinë, më 26 korrik 2018, në orën 19:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 26 KORRIK 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, Xhavit Haliti dhe Kujtim Shala, nënkryetar të Kuvendit

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Shqipe Pantina, Ahmet Isufi dhe Bilall Sherifi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit: Avni Arifi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi dhe Musli Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari i njoftoi të pranishmit se sot ka ndërruar jetë veprimtari i shquar i çështjes kombëtar, Heroi i Kombit, Adem Demaçi. Andaj, qëllimi i kësaj mbledhjeje janë përgatitjet për organizimin e ceremonisë për organizimin e varrimit të Bacës Adem Demaçi.

Me propozimin e kryetarit, Kryesia mbajti një minutë heshtjeje, në shenjë nderimi për ndërrimin e jetës së Adem Demaçit.

Kryetari e hapi diskutimin për këtë çështje.

Lidhur me përgatitjet për organizimin e ceremonisë për organizimin e varrimit të Bacës Adem Demaçi diskutuan: kryetari Kadri Veseli, nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, kryetarët e grupeve parlamentare: Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Shqipe Pantina (përfaqësuese e GP të PSD), Bilall Sherifi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

I.

1. Formohet Këshilli Shtetëror për organizimin e ceremonisë për organizimin e varrimit të Bacës Adem Demaçi, pjesë të cilit, përveç udhëheqësve të institucioneve shtetëror, do të jenë edhe përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

2. Kuvendi do të mbajë seancë komemorative të shtunën, më 27. 7. 2018, në orën 11:00.

3. Në Kosovë shpallen tri (3) ditë zie në shenjë nderimi për ndërrimin e jetës së Adem Demaçit.

II.

Gjithashtu, Kryesia vendosi që seanca plenare, e ndërprerë më 26 korrik 2018, t'i vazhdojë punimet të hënën, më 30 korrik 2018, në orën 10:00, me pikat e papërfunduara, si në vijim:

Rendi i ditës

11. Vazhdimi i debatit parlamentar për dialogun me Serbinë,

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale,

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme,

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës,

15. Propozimi i grupeve parlamentare të AAK-së dhe Nismës Socialdemokrate për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

16. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator për Ujëra për vitin 2017,

17. Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017,

18. Shqyrtimi i raportit vjetor për vitin 2017 i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 19:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale